

Vendim nr. 45 datë 11.03.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 11.03.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MIKLOVAN ZYMERI**, përfaqësuar nga avokate Ina Serjanaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 71, datë 09.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.**
Kthimi i çështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës së Lartë me një tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2014 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka filluar procedimin penal ndaj kërkuesit Miklovan Zymeri dhe dy personave të tjerë për vrasjen e një shtetasi. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokuroria e ka dërguar çështjen në gjyq, duke e akuzuar kërkuesin për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese, në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës, e kryer në bashkëpunim”, të parashikuar nga nenet 79/e dhe 25 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 635, datë 20.10.2016, ka vendosur, ndër të tjera, deklarin fajtor të kërkuesit sipas akuzës dhe dënimin e tij me 35 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 263, datë 06.04.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pjesën që i takon kërkuesit, duke e deklaruar fajtor për veprën penale “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuar nga neni 302, paragrafi i dytë, i KP-së dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim. Për këtë pjesë të vendimit prokurori ka paraqitur rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1071 (71), datë 09.03.2023, ka vendosur prishjen e vendimit për pjesën që i takon kërkuesit dhe dërgimin e çështjes së tij për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.

5. Në datën 05.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1.1. *E drejta e mbrojtjes*, pasi koha e zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë nuk i është njoftuar kërkuesit individualisht dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ai nuk ka marrë dijeni për përbërjen e trupit gjykues, në mënyrë që eventualisht të paraqiste

pretendimet e tij me një kërkesë të argumentuar, ndaj Gjykata e Lartë i ka mohuar edhe të drejtën e aksesit.

6.1.2. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi është regjistruar në datën 30.08.2017 dhe është marrë në shqyrtim pas 5 vjetësh. Ndonëse kërkuesi është interesuar vazhdimisht, Gjykata e Lartë nuk ka marrë asnjë masë për gjykimin e rekursit.

6.1.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse rekursi i prokurorit përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Vendimi është kontradiktor kur argumenton pranueshmërinë ose jo të rekurseve të paraqitura. Gjykata e Lartë, në kundërshtim me ligjin, ka kapërcyer detyrat funksionale të saj, duke i atribuar vetes kompetencat e gjykatave të faktit, pasi ka analizuar provat, ndërsa me ndryshimet ligjore procedurale të vitit 2017, autoriteti i saj është kufizuar vetëm në drejtim të çështjes së zbatimit të ligjit.

6.2. *Lirinë personale*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi kërkuesi e ka përfunduar së vuajturi dënimin me 5 vjet burgim të caktuar nga Gjykata e Apelit Vlorë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është shqyrtuar akuza penale e ngritur ndaj tij, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2023-1071 (71), datë 09.03.2023 të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se ai është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në aspektet e së drejtës së mbrojtjes dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe ka cenuar edhe lirinë personale të tij. Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, për sa i takon kërkuesit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues, me arsytimin se konkluzioni për fajësinë e kërkuesit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural penal. Rrjedhimisht, vendimi objekt kundërshtimi nuk përbën vendim përfundimtar për efekt të gjyqimit kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi nuk ka përmbyllur procesin gjyqësor për themelin e fajësisë së kërkuesit. Kjo do të thotë se kërkuesi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të tij gjatë rigjyqimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

12. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, ku është

përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues ndonjë akt që të provojë se ka përdorur këto mjete ligjore që ka pasur në dispozicion. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion as për pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.